



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:003271

Datë: 29.05.2024

Numri i dokumentit: 05748831

KPPP.nr. 14/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Florent Zeqiri, në çështjen përmbartimore të kreditorit AD Sh.P.K., me numër unik identifikues 810728321 dhe me seli në Çagllavicë, Magjistralja Prishtinë – Ferizaj, nr. 126, kundër debitorit “Berisha Group” Sh.P.K., me numër unik identifikues 810859366 dhe me seli në Prishtinë, që sipas autorizimit përfaqësohet nga avokat Florim Shefqeti nga Prishtina, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr. 1496/23 i datës 19.10.2023, të lejuar nga Përmbartuesi Privat Atip Mustafa nga Mitrovica, jashtë seancës me datën 29.05.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET në tërësi si i pa bazuar prapësimi i debitorit “Berisha Group” Sh.P.K., ashtu që Urdhri Përmbartimor P.nr. 1496/23 i datës 19.10.2023, të lejuar nga Përmbartuesi Privat Atip Mustafa, MBETET NË FUQI.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit AD Sh.P.K., me datë 19.10.2023 ka lëshuar urdhrin P.nr. 1496/23, duke lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit Faturës nr. 115/23, e datës 08.06.2023 dhe Faturës nr. 116/23, e datës 08.06.2023, me të cilin e ka urdhëruar debitorin që t’ia paguajë kreditorit shumën prej 16,891.20 EUR, me kamatë ligjore prej 8 %, si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore.

Debitori, përmes përfaqësuesit të autorizuar brenda afatit ligjor ka ushtruar prapësim me të cilin e ka kundërshtuar urdhrin përmbartimor, me arsyetimin se dokumentet në bazë të së cilave është lejuar urdhri përmbartimor, konkretisht faturat nuk dihet se nga kush janë nënshkruar dhe se a ka

pasur autorizim nga debitori për nënshkrim të tyre, e për më tepër nuk përmban vulën e debitorit. Për këto arsye, i ka propozuar gjykatës që të aprovojë prapësimin e debitorit, ndërsa urdhri përbarimor të anulohet si dhe të detyrohet kreditori që të kompensojë shpenzimet e procedurës përbarimore për përpilimin e prapësimit në vlerë prej 208.00 €.

Kreditori nuk ka paraqitur përgjigje në prapësim.

Gjykata, pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përbarimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është i pabazuar për shkaqet si në vijim:

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa me nën-par.1.3 të këtij neni fatura përcaktohet si një nga dokumentet e besueshme, kurse me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*, dhe me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*.

Gjykata në rastin konkret vlerëson se Fatura nr. 115/23, e datës 08.06.2023 dhe Fatura nr. 116/23, e datës 08.06.2023, i plotëson kushtet për të qenë dokument i besueshëm dhe i përmban të gjitha elementet e kërkuara në përputhje sipas nenit 29 par. 3 të LPP-së, meqenëse në faturë janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara shërbimet të cilat kanë qenë objekt i faturës, është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit si dhe koha e përmbushjes së këtij detyrimi.

Tutje, Gjykata gjeti se faturat e lartcekura janë pranuar në mënyrë të rregullt nga ana e debitorit, fakt ky që vërtetohet nga nënshkrimi i debitorit në fatura, dhe të njëjtat i janë bashkangjitur propozimit për përbarim në origjinal, në përputhje me nenin 37 të LPP-së, dhe si të tilla paraqesin bazë për lejimin e përbarimit pasi që janë të përshtatshme për përbarim.

Pretendimet e debitorit se faturat në bazë të së cilave është lejuar urdhri përbarimor nuk janë të përshtatshme për përbarim gjykata i vlerësoi si të paqëndrueshme pasi që debitori, nuk ka ofruar asnjë provë në kuptim të nenit 69 par.4 të LPP-së për të vërtetuar ekzistimin e një prej

shkaqeve taksative të parapara me nenin 71 të LPP-së mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbarimit, andaj lidhur me refuzimin e prapësimit debitorit, në kuptim të nenit 73 të LPP-së, gjykata ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Nga arsyet e paraqitura më lart dhe duke u bazuar në nenin 73 par të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 14/24, datë 29.05.2024

Gjyqtari

Florent Zeqiri

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.